



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:137138  
Datë: 26.04.2024  
Numri i dokumentit: 05624967

CAP.nr.868/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit A.G., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK), për shkak të borxhit në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1897/20, të datës 29.12.2022, jashtë seance me dt.23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit A.G., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1897/20, të datës 29.12.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.1897/20, të datës 29.12.2022, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar të bazuar prapësimin e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës - SHSKUK, me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.1348/20 të datës 28.05.2020, të lejuar nga Zyra Përmbarimore-përmbaruesit A..M në Prishtinë si dhe e ka refuzuar propozimin për përmbarim të paraqitur me datë 28.05.2020 nga kreditori Afrim Gërvalla nga Prishtina. Në pikën II (dy) ka vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditori nëpërmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i

propozuar Gjykatës së Apelit, që ankesën e kreditorit ta aprovoj si të bazuar, të prishet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, të lihet në fuqi urdhri përmbarimor dhe të detyrohet debitori që t'ia paguaj kreditorit borxhin sipas propozimit me kamatë ligjore prej 8% nga dita e dorëzimit të propozimit për përmbarim deri në pagesën definitive të tij.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 28.05.2020, ka ushtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të titullit ekzekutiv - Vendimit të Inspektoratit të Punës nr. 01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 19.05.2020, të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbarim.

Përmbaruesi Privat Afet Mjeku duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.1348/20 i datës 28.05.2020, e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit debitori ka paraqitur prapësim me të cilin ka theksuar që dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbarim ashtu siç kërkohet me nenin 27 par 1 të LPP –së, pasi në dispozitivin e tij nuk është cekur shuma e të hollave, ashtu siç ka kërkuar kreditori e cila shumë do të përbënte obligim për debitorin, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit QKUK ashtu që Urdhri P.nr.1348/20 i datës 28.05.2020, të anulohet dhe propozimi për përmbarim të hedhet poshtë si i pa bazë.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit i pa bazuar, të vërtetohet urdhri përmbarimor P.nr.1348/20 i datës 28.05.2020, i përmbaruesit privat A.M. dhe të detyrohet debitori që t'ia paguaj borxhin kreditorit si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditores ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1897/20, të datës 29.12.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK), Qendra Klinike Universitare në Prishtinë (QKUK), me seli në Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.1348/20 të datës 28.05.2020 i lejuar nga përmbaruesi privat.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se prapësimi i debitorit është i bazuar sepse dokumenti në bazë të cilit është inicuar procedura nuk është i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se në të nuk është specifikuar shuma e përmbushjes së detyrimit. Tutje ka

shtuar se përmbaruesi privat ka pasur për obligim që të shqyrtojë propozimin për përmbarim e pastaj të caktojë përmbarimin, andaj në rastin konkret ka vlerësuar se urdhri përmbarimor është lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore sipas dispozitave ligjore të LPP-së. Për mënyrën e vendosjes i është referuar dispozitës së nenit 73 të LPP.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorës Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbarimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbarimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbarim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbarimor është i papërshtatshëm për përmbarim edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP-së, në mënyrë shprehimore është paraparë se “*dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbarimor - vendimi administrativ i Inspektoriatit të Punës, Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qendrojnë pretendimet e prapësimit të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbarueshmërisë së dokumentit përmbarimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore se me dt. 18.11.2020 është nxjerrë *aktvendi për korrigjimin e gabimeve në vendimin në bazë të cilit është lejuar përmbarimi dhe arsyeja e mosparaqitjes me propozim është se i njëjti është nxjerrë më pas*, mirëpo të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për shkak se me shikim në shkresat e lëndës vërtetohet se me rastin e parashtrimit dhe lejimit të propozimit për përmbarim i njëjti është lejuar në bazë të vendimit Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, i cili nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i rregullt përmbarimor, për çka fakti se tani është bërë korrigjimi i këtij vendimi nuk ndikon në ndryshimin e vendimit. Duke i vlerësuar të gjitha pretendimet, gjykata ka vlerësuar se pala kreditore as gjatë procedurës e as me ankesë nuk ka propozuar plotësimin e propozimit përmbarimor, por vetëm me ankesë ka parashtruar një

pretendim të tillë, andaj edhe gjykata e shkallës së parë sipas kundërshtimit të debitorit ka qenë e detyruar që të veprojë konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë ka vendosur, pasi që nuk ka pasur njohuri lidhur me korigjimin e vendimit përmbartimor, në ndërkohë që ka qenë detyrim i vetë palës kreditore e cila ka interes në këtë procedurë, që paraprakisht të bëjë edhe precizimin dhe korigjimin e propozimit për përmbartim. Gjykata e Apelit vlerëson se pala kreditore eventualisht mund të parashtrojë propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përmbartimor, pasi që në këtë procedurë ka bërë lëshime të cilat e kanë pamundësuar përmbartimin e propozuar.

Poashtu Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.868/2023, me datën 23.04.2024.

Gjyqtarja,  
Halide Reka d.v.